

VENDIM

Nr. 86, date 13.2.2003

PER LIBREZEN E SHENDETIT

Ne mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 36 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Libreza e shëndetit është dokumenti që vërteton se mbajtësi i saj është person i siguruar, sipas ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Libreza e shëndetit është personale dhe e patjetërsueshme. Përdorimi i librezës nga persona të tjerë nuk lejohet, me përjashtim të rasteve të përcaktuara me udhëzimin e veçantë të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.
3. Forma dhe përmbajtja e librezës së shëndetit përcaktohen nga Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.
4. Te siguarit janë të detyruar të pranojnë në çdo kohë kontrollin nga specialistët e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për të gjitha shërbimet e përfituara, që mbulohen nga skema e sigurimeve shëndetësore.
5. Kontrolli i specialisteve përfshin verifikimin e librezës së shëndetit e të riekzaminimeve mjekësore, nëse është i nevojshëm.
6. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor harton udhëzimin për pajisjen e të siguruarve me librezë shëndeti dhe për plotësimin e përdorimin e tyre.
7. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano